



Universiteti i Elbasanit
"ALEKSANDËR XHUVANI"

**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I HISTORI - GJEOGRAFISË**

organizon

**KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE:
"TRASHËGIMIA DHE TURIZMI NË SHQIPËRI
E RAJON"**

14 Nëntor 2025

Fushat dhe nëntemat kryesore të konferencës:

- Roli i trashëgimisë në zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë në tërësi
- Ndikimet e turizmit mbi trashëgiminë në Shqipëri dhe rajon
- Evidentimi e nxitja e praktikave më të mira, si dhe politikat e qëndrueshme për mbrojtjen e trashëgimisë dhe zhvillimin e turizmit

- Bashkëpunimi midis institucioneve, komuniteteve vendase dhe sektorit privat për menaxhimin efektiv të trashëgimisë
- Turizmi kulturor e historik dhe roli i tij në zhvillimin e qëndrueshëm të trashëgimisë në Shqipëri dhe Ballkan
- Digjitalizimi si mjet për promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë në funksion të turizmit

- Turizmi komunitar dhe roli i banorëve vendas në ruajtjen e trashëgimisë: Përfitimet ekonomike kundrejt ruajtjes së identitetit kulturor
- Ndikimi i turizmit masiv në trashëgiminë natyrore dhe kulturore
- Gjuha shqipe si element i trashëgimisë dhe kulturës sonë

- Bordi shkencor i konferencës do të bëjë vlerësimin e punimeve, mbështetur në përputhshmërinë e tyre me fushat e temave të përcaktuara, origjinalitetin dhe qartësinë e të shkruarit. Punimet e pranuar do të botohen në Përmbledhjen e konferencës, me indeksin ISBN.
- Pjesëmarrja në konferencë është pa pagesë.
- Një autor ose bashkautor nuk mund të përfshihet në konferencë me më shumë sesa dy punime.
- Pjesëmarrja në konferencë: Fizike
- Gjuha e konferencës: Shqip / Anglisht.

Data të rëndësishme

- | | |
|---------------------------|-------------------------------------|
| » 1 nëntor, 2025 | Dorëzimi i abstrakteve |
| » 5 nëntor, 2025 | Njoftimi për pranimin e abstrakteve |
| » 14 nëntor, 2025 | Data e konferencës |
| » 15 dhjetor, 2025 | Dorëzimi i punimeve të plota |



Dërgimi i punimeve do të bëhet në:

konferenca.fshh@uniel.edu.al

artan.lila@uniel.edu.al



Vendi: Korpusi Qëndror, Universiteti i Elbasanit

Do ju ishim mirënjohës nëse ju e shpërndani këtë **Thirrje** me të tjerë kolegë, bahkëpunëtorë të njohur e interesuar të fushës dhe tematikës.

Abstraktet e dorëzuara duhet të shkruhen në përputhje me udhëzimet e mëposhtme:

Abstrakti: Abstrakti i punimeve të paraqitura duhet të dërgohet në gjuhën shqipe dhe anglisht. Abstrakti duhet të tregojë qartësisht qëllimin e kërkimit dhe lidhjen e tij me temën e Konferencës, dhe me seksionin përkatës, qasjen e përdorur, rezultatet kryesore të kërkimit dhe rëndësinë e tyre.

Përmbajtja e abstraktit: 250 – 400 fjalë (12pt Times New Roman, Bold, Justify, Hapësira mes rreshtave 1.5) dhe të paraqesë qëllimin dhe metodologjinë e kërkimit, rezultatet dhe rekomandimet.

Titulli i punimit: 14 pt Times New Roman, Bold, i qendërzuar, me shkronja të mëdha.

Emrat e autorëve: Emri i plotë i autorit (autorëve), statusi, institucioni dhe adresa e-mail për secilin prej autorëve. (Me shkronja të mëdha, 12 pt Times New Roman, në qendër. Institucioni ose Departamenti dhe Universiteti (12 pt Times New Roman, në qendër. E-mail(për komunikim) 12pt Times New Roman, në qendër, i rrafshuar në të dy skajet).

Fjalët kyçe: 5-7 fjalë të renditura në rend alfabetik (12pt Times New Roman, Normal). Fjalët kyç është mirë që të përmbledhin temën, nëntemën, llojin e studimit, popullatën, vendin e zbatimit të studimit.

Formati: Abstrakti duhet të dorëzohet në format Microsoft Word, shkrimi në formatin A4, lloji i gërmës: 12 pt., font - Times New Roman.